



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Thirrje publike për të aplikuar si auditues ligjor për auditimin e subjekteve zgjedhore, si dhe të kandidatëve për kryetar bashkie, për fushatën zgjedhore të datës 6 mars 2022.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes këtij njoftimi, bën thirrje publike për shfaqje interesi për të qenë ekspert kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 6 Mars 2022.

Ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjor), përveç kushteve të përgjithshme të ushtrimit të profesionit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duhet të plotësojnë njëkohësisht edhe kriteret e mëposhtme:

1. Të ushtrojnë profesionin e ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor) për jo më pak se 5 (pesë) vitet e fundit;
2. Të mos kenë marrë masa disiplinore në fuqi;
3. Të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike në 5 (pesë) vitet e fundit;
4. Të mos ketë qenë kandidat i mbështetur nga ndonjë parti politike, koalicion apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit në 2 zgjedhjet e fundit;
5. Prindërit, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të mos jenë anëtarë i partisë politike objekt i auditimit.

Aplikantët duhet të dorëzojnë brenda datës 11.03.2022 në mënyrë elektronike në email-in Krist.Puleri@kqz.gov.al ose fizikisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dokumentat si më poshtë vijon:

1. Kopje të noterizuar të licencës të ekspertit kontabël të licensuar (auditues ligjor), lëshuar nga IEKA, e vlefshme për vitin kalendarik respektiv;
2. Vërtetim nga IEKA që vërteton se eksperti kontabël i licensuar (audituesi ligjor) ka jo më pak se 5 (pesë) vite eksperiencë dhe se nuk ka masë disiplinore në fuqi;
3. Fotokopje të dokumentit të identifikimit;

4. Deklaratë vetjake se nuk është në kushtet e parashikuara në shkronjat “c”, dhe “d”, të sipërcituar, sipas formatit të miratuar në shtojcën 1 bashkëlidhur udhëzimit nr. 14 datë 09.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”;
5. Raport mjeko-ligjor;
6. Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Pas përfundimit të periudhës së aplikimit, Komision i Posaçëm i ngritur me urdhër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve realizon, brenda 5 (pesë) ditëve, verifikimin e plotësimit të kriterëve formale të sipërcituara. Brenda 3 (tre) ditëve nga miratimit i listës paraprake hidhet shorti për caktimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor).

